

VENDIM

Nr. 1 Datë 10/01/2021

**“PËR SHPËRNDARJEN E GRANTIT TË AKORDUAR NGA MINISTERIA E
ARSIMIT SPORTIT & RINISË DHE REGJISTRIN E PROKURIMEVE ME BURIM
FINANCIM GRANTI, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR
VITIN KALENDARIK 2021”.**

Në zbatim të nenit 3, pika 3 dhe nenit 49 e vijim ... të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administratorja e Universitetit të Arteve, Znj. Alma Sinanaj për “Shpërndarjen e grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe regjistrin e prokurimeve me burim financimi grantin e vitit 2021”, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitin kalendarik 2021, në Universitetin e Arteve, sipas tabelës Nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Miratimin e regjistrit të prokurimeve me burim financimi grantin e vitit 2021, për vitin kalendarik 2021, në Universitetin e Arteve, sipas tabelës Nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare dhe të dërgohet në Ministri të Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Risena Xhaja (Kryetar)

Prof. Besnik Bisha (Anëtar)

Prof. Arben Basha (Anëtar)

Aida Martiro (Anëtar)

Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)

Lorenc Vangjeli (Anëtar)

Vladimir Llakaj (Anëtar)

